



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Prodatori Received/Deivrsary	08.09.2023	3	vite god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKAMSHICK	6024/2023		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1035/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1035/2023 të datës 27.07.2023 të ankuesi _____ me adresë rruga _____, kundër Vendimit DBNJ 01/2023 të datës 21.07.2023 të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1035/2023 e datës 27.07.2023 e parashtuar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi DBNJ 01/2023 i datës 21.07.2023 i Divizionit të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

A r s y e t i m

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore më datë 06.06.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr.Reference: RN00011820 për grupin Specialist të Përgjithshëm të Trashëgimisë Kulturore respektivisht për pozitën Zyrtar i Lartë për Trashëgimi Kulturore, ku afati për aplikim ka qenë nga data 27.06.2023 deri më datë 11.07.2023.

Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, ku më datë 14.07.2023 nga Divizioni i Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, që i është refuzuar aplikacionit për

shkak mos plotësimi të kriteret e konkursit. Ankuesi ka parashtruar ankesë në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, ndërsa Divizioni i Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore përmes Vendimit DBNJ 01/2023 të datës 21.07.2023 ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit DBNJ 01/2023 të datës 21.07.2023 të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, më datë 27.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 5385/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 02.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Ndërsa Këshilli me datë 02.08.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën e datës 27.07.2023 me numër protokoll 5385/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Dokument identifikimi i ankuesit; Konkursin me Nr.References: RN00011820 për grupin Specialistë të Përgjithshëm të Trashëgimisë Kulturore respektivisht për pozitën *Zyrtar i Lartë për Trashëgimi Kulturore*; Njoftimin e datës 14.07.2023; Anesën e ankuesit në Divizionin për Burime Njerëzore; Vendimin DBNJ 01/2023 të datës 21.07.2023 të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore; Kontratë Pune me Nr. prot: 3/818 e datës 06.12.2016; Kontratë Pune me Nr. Prot: 153 e datës 14.01.2015; Vërtetimin e datës 07.11.2022; Certifikatën mbi dënimet penale e datës 06.02.2023; Vendimin me Nr. 436/09 i datës 02.11.2009; Diplomë Master; Licencë; Vendimin me Nr. 406/2009 të datës 01.10.2009; Licencë Profesionale e datës 28.03.2023; Rekomandimin e datës 23.08.2017, 02.11.2009; Vërtetimin e datës 20.08.2007; Letër reference e datës 07.11.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.08.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 03.08.2023; Listën e aplikantëve; Aplikacionin e ankuesit i datës 29.06.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pabazuar, sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit DBNJ 01/2023 të datës 21.07.2023 të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, pretendon se dokumentet që janë kërkuar në konkurs i kam ngarkuar, dhe për këtë kam dëshmi.

Kolegji i Këshillit, konstaton se në konkursin Nr. Reference: RN00011820 për grupin Specialistë të Përgjithshëm të Trashëgimisë Kulturore respektivisht për pozitën *Zyrtar i Lartë për Trashëgimi Kulturore*, kriteret e përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve në trashëgimin kulturore arkeologjike;*
- *Përvoja e punës: Se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës.*



Në pikën 7 të këtij konkursi si dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim janë: *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, Kopje e dëshmisë së punësimit; Kopjet e dëshmisë së trajnimeve; Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit; Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.*

Në kuptim të kërkesave të përgjithshme formale për pranimin e zyrtarëve publikë të paraparë me nenin 8 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht me paragrafin 1, përcaktohet se: *“Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar; 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji”,* ndërsa sipas nenit 12 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurimit, kandidatët duhet të bashkangjitin edhe dokumentacionin si në vijim: 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurimit dhe të deklaruara në aplikacion”.*

Bazuar në dispozitat e cekura më lartë, e që kanë të bëjnë me kërkesat për pranim në shërbimin civil, Kolegji i Këshillit, konstaton se në bazë të provave të lëndës, ankuesi nuk është duke ushtruar ndonjë pozitë të zyrtarit publikë/shërbimit civil, mirëpo edhe përkundër kësaj i njëjti nuk ka ofruar ndonjë deklaratë me shkrim i cili do të pohonte që përveç që nuk është duke ushtruar ndonjë pozitë të zyrtarit publikë/shërbimit civil do të duhet të pohonte faktin që nuk ka ndonjë masë disiplinore në fuqi. Po ashtu duke marr parasysh faktin që sipas provave të lëndës konkretisht dokumentacionin që ka dorëzuar ankuesi me rastin e aplikimit, rrjedh se i njëjti pohon se nga data 01.10.2014 deri më datë 15.02.2023 ka përvujë punë në Universitetin e Prishtinës, ndërsa nga data 01.06.2012 deri më datë 30.11.2018 ka përvujë punë në Institutin Arkeologjik të Kosovës, mirëpo nuk ka ofruar dëshmi të vlerësimeve të rezultateve në punë për dy vitet e fundit, ngase meqë i njëjti ka punuar në institucione publike është dashur edhe të ketë vlerësim të rezultateve në punë e në rastin konkret ankuesi nuk ka bashkangjitur dëshmi të tilla.

Duke marr parasysh dokumentacionin e dorëzuar nga ankuesi me rastin e aplikimit, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi nuk ka dorëzuar dy nga dokumentet e kërkuara sipas pikës shtatë (7) të konkursit respektivisht *Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit; Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende,* si rezultat i kësaj mos dorëzimi i këtyre dëshmimeve ka pamundësuar që ankuesi të përfshihet në listën e ngushtë, ngase dorëzimi i dëshmimeve të tilla është kusht ligjor për pranim të zyrtarëve publikë.

Nisur nga baza ligjore e përmendur si më lartë, dhe nga vlerësimi i provave të lëndës, respektivisht dëshmitë e dërguar nga ankuesi me rastin e aplikimit, rrjedhë se ankuesi nuk ka përmbushur kriteret për të kaluar fazën e verifikimit paraprak ngase nuk ka dëshmuar me prova materiale përvujë e punës, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se vendimi i kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimi DBNJ Nr.01/2023 i datës 21.07.2023 i Divizionit të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse i njëjti është nxjerr në frymën ligjore dhe mbi bazë të gjendjes faktike dhe duke u respektuar kompetenca dhe hierarkia ligjore e përcaktuar me nenin 34 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për



Zyrtarët Publikë, nenin 12 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2, nenin 15 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe se i njëjti është i arsyetuar në pajtim me dispozitat e nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, nga konstatimi si më lartë, thekson faktin se me vendimin e kundërshtuar me ankesë, ankuesit nuk i është cenuar asnjë e drejtë nga e drejta për t'iu nënshtruar procedurave të tjerë të pranimit ngase obligimi për të dorëzuar dokumentacionin së bashku me aplikacionin është obligim i kandidatit, ri rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit konstaton se të gjitha pretendimet e ankuesit janë të pabazuara për shkak që nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe faktike, sepse refuzimi i aplikacionit të ankuesit nuk është bërë për shkak të mos plotësimit të kriterëve në aspektin e përgatitjes profesionale apo në aspektin e mos përmbushjes së përvojës së punës por është bërë vetëm që nuk ka dorëzuar dy dëshmitë e cekura si ma lartë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.1035/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

